



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 mars 2024
Nr. Ref.:RK 2403/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI188/22

Parashtrues

Isak Shehu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr.
580/2022 të 11 janarit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Isak Shehu nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Jeton Osmani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Në kërkesën KI188/22 parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata ta korrigjojë aktvendimin e saj për papranueshmëri në rastin KI83/22, të 12 tetorit 2022, dhe ta bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit [Rev. nr. 580/2022] të Gjykatës Supreme të 11 janarit 2022.
3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës më 4 shkurt 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është (i) vlerësimi i pretendimit të parashtruesit të kërkesës se në Aktvendimin për papranueshmëri KI83/22 ka ndodhur një lëshim teknik gjatë llogaritjes së afateve lidhur me afatshmërinë e kërkesës së tij, dhe (ii) Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit [Rev. nr. 580/2022] të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Llogaritja e periudhës kohore] paragrafi (1) (g), rregullin 25 [Parashtimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullin 48 [Vendimet e Gjykatës] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 28 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 30 nëntor 2022, Gjykata e pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
9. Më 5 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI188/22] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi, anëtarë.

10. Më 9 dhjetor 2022, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta plotësojë formularin standard të kërkesës.
11. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
12. Më 30 dhjetor 2022, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi formularin e plotësuar të kërkesës.
13. Më 7 qershor 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe vendosi që vendimmarrja për raportin të shtyhet për njërën nga seancat e radhës.
14. Më 18 janar 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Bazuar në shkresat e lëndës, gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte marrëdhënie pune me Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK) nga viti 1979 deri në vitin 2018, kur ai doli në pension. Rrjedhimisht, ai parashtroi kërkesë në KEK, përmes së cilës kërkoi njohjen e së drejtës për (3) tri shpërblime jubilarë, mirëpo më 14 dhjetor 2018, KEK-u nxori vendimin [nr. 1527] përmes të cilit refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar.
16. Duke pasur parasysh këtë, më 23 maj 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore kundër vendimit [nr. 1527] të KEK-ut, përmes së cilës kërkoi *“që t'i paguhen tri paga jubilarë në vlerë të përgjithshme prej 4235,82 (katër mijë e dyqind e tridhjetë e pesë euro e tetëdhjetë e dy cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën përfundimtare”*.
17. Më 11 tetor 2019, Gjykata Themelore, me aktgjykimin [C. nr. 1791/2019], aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe obligoi të paditurën KEK që t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës shumën prej 3,960 (tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) euro me kamatë prej 8%. dhe shpenzimet e procedurës në vlerë prej 175 euro nga dita e marrjes së aktgjykimit, dhe të gjitha brenda afatit prej 7 ditëve.
18. Në arsyetimin e aktgjykimit [C. nr. 1791/2019], ndër të tjera Gjykata Themelore theksoi:

“Më 18.03.2014, është nënshkruar Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nga palët kontraktuese Qeveria e Kosovës, Kryeministri, për punëdhënësit Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit, për të punësuarit në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe kryesuesi i Këshillit Ekonomiko-Social. Marrëveshja Kolektive ka hyrë në Fuqi më 01.01.2015.

Me dispozitën e nenit 52 të Marrëveshjes Kolektive janë rregulluar “Shpërblimet jubilarë dhe atë: “I punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: .për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; dhe .për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”; “ 2. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë”; 3 “Shpërblimi

jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

Sipas vendimeve të administratës së të paditurës KEK, më 10.04.2019 dhe më 23.08.2019, është rregulluar pagesa e pagave jubilarë për periudhën 2015 - 2019, sipas së cilës e paditura ka marrë përsipër detyrimin për pagesën e pagave jubilarë.

Gjykata vlerëson se vendimet e të paditurës për pagesën e pagave jubilarë për punonjësit janë normë materiale dhe si bazë ligjore përfaqëson të drejtën subjektive të paditësit siç është përcaktuar në dispozitiv.”

19. Më 4 nëntor 2019, KEK-u parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit [C. nr. 1791/2019] të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 11 qershor 2021, Gjykata e Apelit, me aktgjykimin [Ac. nr. 1444/20], aprovoi ankesën e KEK-ut, duke ndryshuar aktgjykimin [C. nr. 1791/2019] e Gjykatës Themelore të 11 tetorit 2019, ashtu që refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
21. Në arsyetimin e aktgjykimit [Ac. nr. 1444/20], Gjykata e Apelit, ndër të tjera, theksoi:

“Në këtë rast, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës [...] Me këto dispozita përcaktohet e drejta e punëmarrësit për shpërblim jubilar, por në rastin konkret është bazë, megjithatë, nuk ka qenë e mundur të mbështetet në këtë dispozitë sepse Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka filluar të zbatohet nga 01.01.2015, me kohëzgjatje prej tre vjetësh, përkatësisht deri më 31.12.2017, kur ka skaduar afati për zbatimin e së njëjtës, përkatësisht ka pushuar efekti juridik. Me skadimin e afatit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e njëjta nuk mund të zbatohet për rastet tjera pas datës 31.12.2017, dhe as në rastin e paditësit, pasi që paditësi ka parashtruar padi në gjykatë më 31.05.2019, pas përfundimit të zbatimit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës”.

22. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit [Ac. nr. 1444/20] të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 11 janar 2022, Gjykata Supreme nxori aktvendimin [Rev. nr. 580/2021], përmes të cilit refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për revizion të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
24. Në arsyetimin e aktgjykimit [Rev. nr. 580/2021], Gjykata Supreme, ndër të tjera, deklaroi:

“[...] me dispozitën e nenit 2 të Ligjit të Punës parashihet se “Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës”. Me dispozitën e nenit 90, paragrafi 4, të këtij ligji, parashihet se “Marrëveshjet kolektive mund të lidhen për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tre (3) vjet”. Kurse me paragrafin 5 të tij, parashihet se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënësit dhe punëmarrësit

të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”, gjë që këtu, në këtë çështje juridike nuk është rast, ndërkohë që Marrëveshja Kolektive nuk ka efekt retroaktiv. Ndërsa me dispozitat e Ligjit të sipërpërmendur nuk është e paraparë e drejta e punëtorit për pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse për shkuarjen në pension të pleqërisë. Me dispozitat e nenit 7 të po të njëjtit ligj, është paraparë që pensioni i vjetërsisë dhe i përkohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Nga këtu dhe në prani të rrethanave, fakteve si dhe nga arsyet e sipër përmendura, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, nga se vërtetë, në rastin konkret civil-juridik, mungon baza ligjore që pagat jubilarë kontestuese t'i paguhen paditësit nga ana e të paditurës, prandaj, ndaj në kontekstin e mësipërm, edhe pretendimet e revizionit janë të paqëndrueshme.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën KI188/22 paraqet pretendime në bazë të të cilave ai konsideron se “Gjykata Kushtetuese, me vendimin për papranueshmërinë me numër KI83/22, gabimisht e ka shpallur kërkesën të papranueshme pasi e ka konsideruar kërkesën e Isak Shehut jashtë afatit ligjor, duke konsideruar se kërkesa e paraqitur pas afatit të parashikuar në nenin 49”.
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kërkesa e tij është parashtruar brenda afatit ligjor dhe se Gjykata Kushtetuese ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, përkatësisht ka llogaritur gabimisht afatet ligjore në kuptim të rregullit 30, paragrafi 6 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.
27. Prandaj, parashtruesi i kërkesës sqaron se “rregullit 30 par. 4 të rregullores së punës ne rastet kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore, dhe në kuptim të rregullit 30 par. 6 të rregullores së punës nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë feste zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.”
28. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shton “se data 04 qershor 2022 ka qenë ditë e shtunë, dite kur Gjykata Kushtetuese nuk punon, dhe në kuptim të rregullit 30 par. 6 të rregullores së punës parashtruesi i kërkesës konsiderohet se ka qenë brenda afateve ligjore deri në ditën e parë të punës, pra ditën e hënë e që kjo është data 06 qershor 2022”.
29. Në fund, parashtruesi i kërkesës pretendon se “ka dorëzuar kërkesën më 06 qershor 2022 dhe në kuptim të situatës së lartcekur konsiderohet se është brenda afatit ligjore për dorëzimin e kërkesës brenda 4 muajsh nga data e pranimit në kuptim të nenit 49 të ligjit mbi Gjykatën, andaj i propozojmë Gjykatës Kushtetuese që në kuptim të lartcekurave ta aprovojë kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme në rastin KI 83/22”.
30. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesit në kërkesën KI 83/22.
31. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën KI 83/22, kontestoi Aktgjykimin [Rev. nr. 580/2021] e Gjykatës Supreme të 11 janarit 2022, duke pretenduar, se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta

për Mjete Juridike], 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Pretendimi për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së

32. Për sa i përket pretendimit për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës konsideron se ka ardhur deri te shkelja e nenit të sipërpërmendur të Kushtetutës për shkak se, siç thekson ai, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë vendosur ndryshe në raste të ngjashme, duke e vënë atë në pozitë të pabarabartë para ligjit.

Pretendimi për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

33. Lidhur me pretendimin për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme në aktgjykimet e tyre kanë konstatuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale, sepse *“...e paditura e ka rregulluar edhe çështjen e shpërblimeve jubilarë me një akt të brendshëm që është ende në fuqi, duke parashikuar që e paditura t’ua njohë punonjësve shpërblimet jubilarë kur kushtet e biznesit dhe financiare janë të përshtatshme për të paditurën”*.
34. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *“Gjykata është dashur të ketë parasysh se është fakt notor se KEK sh. a. si punëdhënës është një nga Korporatat më të fuqishme në vend si për nga fuqia afariste ashtu edhe për nga gjendja financiare por gjithashtu edhe faktin se e paditura si punëdhënës është dashur që ti njeh paditësit të drejtën e tij për pagë jubilarë në afatin prej 30 ditësh duke u bazuar në nenin 52 të MPKK dhe atë pas plotësimit të kushteve të parapara në nenin 52 par. 1 të MPPK lidhur me nenin 53.4 të Kodit të punës së KEK sh.a. Por Gjykata gjithashtu nuk merr për bazë faktin se paditësi tek pas refuzimit të paditurës që ti njeh të drejtën e pagës jubilarë, kishte paraqitur padinë në Gjykatë për realizimin e të drejtës së tij në pagë jubilarë. Për më tepër kërkesëpadia e paditësit është e bazuar edhe nga fakti se duke u bazuar në nenin 53.4 të kodit të punës të KEK Sh.a e paditura ka paraparë njohjen e një të drejte të tillë dhe e paditura kodin e punës e ka ende në fuqi dhe te e paditura punohet ende në harmoni me këtë kod, andaj edhe në kuptim të kësaj kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e bazuar dhe e njëjta është paraqitur në Gjykatë në kuadër të afateve ligjore për njohjen e të drejtës së saj për pagë jubilarë për më tepër kjo e drejtë i takon edhe pasi që një të drejtë të tillë është njohur edhe nga vet e paditura me vendimet 2244 dt. 10.04.2019 dhe plotësimin e tij me nr. 8261 dt.23.08.2019 i ka njohur një të drejtë të tillë të gjithë punëmarrësve si dhe në nenin 3 të këtij vendimi i ka njohur edhe kësaj kategorie të punësuarve të drejtën e tyre në tri paga jubilarë”*.
35. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson se gjykatat e rregullta nuk kanë vepruar në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë çështjen e gjykimit të drejtë dhe zbatimin e së drejtës materiale, sepse *“... me rastin e marrjes së aktgjykimit për revizionin paraqitur nga paditësi para Gjykatës Supreme konkretisht dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore si dhe Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore gjatë marrjes së vendimeve. Sipas pretendimeve të paditësit, mos veprimi i Gjykatës sipas dispozitave ligjore kishte rezultuar në refuzim të Revizionit të tij, dhe rrjedhimisht, atij i ishte pamundësuar që të merr një përgjigje përfundimtare nga gjykatat sa i përket meritave të rastit të tij.”*

36. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës konsideron se janë shkelur të drejtat e tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe për shkak të veprimeve të sipërpërmendura, paditësi nuk ka mundur të përdorë mjet të jashtëzakonshëm juridik pranë gjykatave të rregullta, duke e penguar atë në mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës.

Pretendimi për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së

37. Sa i përket pretendimit për shkeljen e nenit 13 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson se është shkelur edhe parimi i barazisë së armëve, sepse ai ishte vendosur në pozitë të pafavorshme ndaj të paditurës, për shkak se e drejta materiale nuk ishte zbatuar në lidhje me mjetin juridik efektiv.
38. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) ta aprovojë kërkesën dhe (ii) ta anulojë aktgjykimin [Rev. nr. 580/2022] të Gjykatës Supreme të 11 janarit 2022.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër persona.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

[...]”

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

1. *"Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.*
2. *Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.*
3. *Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.*
4. *Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.*
5. *Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese."*

KONVENTA EVROPIANE PËR TE DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij [...]"

Neni 13
(E drejta për zgjidhje efektive)

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

Ligji i Punës nr. 03/L-212

Neni 87 Afati i parashkrimit

"Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës."

Neni 90

Marrëveshja Kolektive [...]

"4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet."

Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore nr. 04/L-077

Neni 357 Kërkesa e shpërblimit të dëmit

“1. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.”

[...]

MARRËVESHJA E PËRGJITHSHME KOLEKTIVE E KOSOVËS (në fuqi prej 1 janarit 2015 deri më 31 dhjetor 2017)

Neni 52 Shpërblime jubilarë

“1. I punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë:

1.1. për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij;

1.2. për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij;

1.3. për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij.

2. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë.

3. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

MENDIM JURIDIK PËR SHPËRBLIMIN JUBILAR I Gjykatës Supreme lidhur me ligjin e aplikueshëm, marrëveshja e përgjithshme kolektive dhe kontratat sektoriale, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar, i 27 shkurtit 2023

Marrëveshja/Kontratat e aplikueshme:

“II. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur më datë 18.03.2014, dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), (në tekstin e më tej: Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës) aplikohet në periudhën kohore nga data 01.1.2015 – 31.12.2017

[...]

Kushtet për të fituar të drejtën shpërblimit jubilar:

VI. *I punësuar në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 52, të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë e pandërprerë te punëdhënësi i fundit*

[...]

Arsyetimi i Mendimit Juridik

Gjykata Supreme e Kosovës në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta ka konstatuar praktikë jo unike lidhur me çështjen e kërkesave për shpërblimin jubilar. Praktika jo unike e gjykatave të instancave më të ulëta kryesisht ka të bëjë me periudhën kohore që duhet të aplikohen marrëveshja e përgjithshme kolektive

dhe kontratat sektoriale, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar.

Arsyetimi për pikën VI (gjashtë) të mendimit juridik

Në praktikë është paraqitur si dilemë, se viti jubilar I punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet, a duhet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet a duhet të jetë e pandërprerë te punëdhënësi i fundit. Në praktikën gjyqësore janë konstatuar interpretime, vlerësime dhe mënyra të ndryshme të vendosjes, lidhur ma atë se cilat kushte duhet të plotësohen për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës është se: i punësuar në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 52 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë e pandërprerë te punëdhënësi i fundit, për arsye se me nenin 52 të kësaj marrëveshjeje, përcaktohet se: "I punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: a) për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; b) për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; dhe c) për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij." Nga interpretimi i nenit 52 paragrafi 1 i kësaj marrëveshje, rezulton qartë se i punësuar për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar duhet ti plotësojë kushtet e theksuara si në pikën II, dhe VI, të këtij mendimi juridik.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

39. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

41. Gjykata më tej shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, siç parashikohet më tej në Ligj, përkatësisht në nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, të cilat parashohin:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

i) Në lidhje me pretendimin e parashtruesit nga kërkesa KI 188/22 “se kërkesa KI 83/22 është dorëzuar në afatin ligjor”

42. Në rastin konkret, Gjykata, përpara se të vazhdojë me procedurën e mëtejshme në lidhje me këtë kërkesë, duhet të shqyrtojë pretendimet në lidhje me lëshimin teknik gjatë llogaritjes së afateve lidhur me parashtrimin e kërkesës në rastin KI 83/22 dhe se si pasojë e kësaj, në bazë të nenit 49 të Ligjit, dhe rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) pika (1) (c) e Rregullores së punës nr. 01/2018, Gjykata e deklaroi kërkesën përkatëse të papranueshme si të pasafatshme.
43. Në mbështetje të kësaj, Gjykata i kthehet përmbytjes së rregullit të lartpërmendur 29 [Llogaritja e periudhës kohore] të Rregullores së punës Nr. 01/2023 e cila është në fuqi, ku në paragrafin (1) (g) relevant theksohet,

[...]

(g) Ndryshe, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.”

44. Gjykata, duke e lidhur rregullin 29 e lartpërmendur, paragrafin (1) (g) të Rregullores së punës, me rrethanat e rastit konkret lidhur me afatet për pranimin e aktgjykimit të kontestuar [Rev. nr. 580/2022] të Gjykatës Supreme, si dhe me datën e parashtrimit të kërkesës KI 83/22 vëren si në vijim; parashtruesi i kërkesës ka pranuar aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 4 shkurt 2022, i cili në kuptimin formalist të interpretimit të afatit kohor, të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34.1 (c) të Rregullores së punës, do të thotë se kërkesa mund të dorëzohet në Gjykatë më 4 qershor 2022.
45. Megjithatë, duke shqyrtuar ditët e javës së qershorit 2022, Gjykata vëren se 4 qershori 2022, është dita e parë e fundjavës, përkatësisht e shtunë, që në fakt do të thotë se afati i fundit për paraqitjen e kërkesës, në pajtim me paragrafin (1) (g) të rregullit 29 të Rregullores së punës, “ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj”, që në rastin konkret nënkupton deri në fund të 6 qershorit (e hënë) 2022.

46. Rrjedhimisht, në mënyrë që kërkesa KI 83/22 të konsiderohet si kërkesë e parashtruar brenda afatit, ajo do të duhej të dorëzohej në ditën e parë të punës pas skadimit të afatit 4-mujor që përfundoi në fundjavë.
47. Prandaj, me qëllim që Gjykata të konstatojë nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës nga kërkesa KI 188/22 janë të bazuara, Gjykata i kthehet fakteve të kërkesës së mëparshme KI 83/22, duke vënë në dukje se parashtruesi i kërkesës e ka dërguar kërkesën e tij në Gjykatë përmes postës më 6 qershor 2022, pra të hënën, që në kuptimin konkret do të thotë se kërkesa KI 83/22 mund të konsiderohet si kërkesë e parashtruar në afatin e paraparë me nenin 49 të Ligjit.
48. Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesit të kërkesës nga kërkesa KI 188/22, në lidhje me pohimin “*se kërkesa KI 83/22 është dorëzuar brenda afatit ligjor*”, është i bazuar, dhe rrjedhimisht, në vijim, Gjykata do të shqyrtojë plotësimin e kërkesave të tjera procedurale në lidhje me kërkesën e parashtruesit për të përcaktuar nëse kërkesa mund të shqyrtohet në kuptimin thelbësor në lidhje me shkeljet e pretenduara të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së.
49. Megjithatë, përpara se Gjykata ta bëjë këtë, e sheh të nevojshme të konstatojë se, për shkak të specifikave të mënyrës dhe datës së dorëzimit të kërkesës KI 83/22, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kushteve procedurale të kërkesës së paraqitur për sa i përket afatit të dorëzimit, është bërë një lëshim teknik në lidhje me llogaritjen e afatit sepse nuk është vërtetuar rrethana se: **i)** kërkesa është dorëzuar me postë, dhe se **ii)** kërkesa është dorëzuar në ditën e cila llogaritet se hyn në afatin prej katër (4) muajsh. Pikërisht si pasojë e lëshimit teknik është konstatuar se kërkesa ishte e pasafatshme. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa KI83/22 është dorëzuar brenda afatit prej katër (4) muajsh.
50. Prandaj, për sa i përket plotësimit të kushteve të tjera të cekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii. ai konteston kushtetutshmërinë e aktgjykimit [Rev. nr. 580/2022] të Gjykatës Supreme të 11 janarit 2022. iii. ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; iv. Ka theksuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, për të cilat pretendon se janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v. e ka parashtruar kërkesën në afat prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
51. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 34 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.
52. Gjykata së pari thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
53. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm

përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave, si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih rastet e GJEDNJ-së, [Kemmachev kundër Francës](#) kërkesa nr. [17621/91](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Lituanisë](#), kërkesa nr. [71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#) kërkesa nr. [4241/03](#), kategoria (iii)).

ii) Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit [Rev. nr. 580/2022] të Gjykatës Supreme

54. Me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës KI 188/22, përkatësisht vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
55. Duke iu rikthyer pretendimeve konkrete të parashtruesit të kërkesës, të cilat në fakt paraqesin pretendime thelbësore nga kërkesa KI83/22, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës konsideron se të drejtat e garantuara me nenet 24, 31, 32, 54 dhe 102 të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së, kanë ndodhur për shkak se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk ia njohën atij të drejtën për shpërblimet jubilarë që ai konsideron se i përkasin.
56. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se shkelja e neneve të sipërpërmendura ka ndodhur për faktin se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme në vendimet e tyre kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale, sepse. “*...e paditura e ka rregulluar çështjen e shpërblimeve jubilarë edhe me një akt të brendshëm që është ende në fuqi, duke parashikuar që e paditura t'ua njohë punonjësve shpërblimet jubilarë kur kushtet e biznesit dhe financiare janë të përshtatshme për të paditurën.*”
57. Ky zbatim i pretenduar i gabuar i së drejtës materiale reflektohet në zbatimin e nenit 52 të Marrëveshjes Kolektive, nga ana e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Gjykata rikujton se neni 52 i Marrëveshjes Kolektive në përmbajtjen e tij parashikon kushtet për ushtrimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, të cilat janë në formën e pagesës së shpërblimeve jubilarë për punonjësit e ndërmarrjes të cilët në një periudhë të caktuar kohore kanë plotësuar vitet e përcaktuara të përvojës së punës pranë punëdhënësit.
58. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata vë në dukje se pretendimet për shkeljen e të drejtave kushtetuese të parashtruesit të kërkesës i referohen mënyrës se si Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme vërtetuan gjendjen faktike dhe zbatuan të drejtën materiale, kur vendosën për realizimin e së drejtës për shpërblimet jubilarë të cilat parashtruesi i kërkesës konsideron se i takojnë. Gjykata rikujton se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e e “*shkallës së katërt*”, që do të

rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së: [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës: [KI145/20](#), parashtruese: *Hafize Gashi*, aktvendim për papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 34, [KI49/19](#), parashtrues: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A. "Adem Jashari"*, aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 48.

59. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; shih gjithashtu edhe rastin e Gjykatës [KI154/17 dhe KI05/18](#), parashtrues: *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, aktvendim për papranueshmëri i 12 gushtit 2019, paragrafi 64). Ne parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka "aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar me "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" për parashtruesin përkatës.
60. Duke iu rikthyer kërkesës konkrete të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se si shkelje kryesore, parashtruesi i kërkesës thekson shkeljen e së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ndërsa pjesën tjetër të shkeljes së neneve të Kushtetutës e sjell në lidhje me drejtësinë e procedurës gjyqësore. Rrjedhimisht, Gjykata do të shqyrtojë më poshtë mënyrën se si gjykatat e rregullta, duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit përkitazi me realizimin e së drejtës për shpërblimin jubilar, zbatuan të drejtën materiale.
61. Rrjedhimisht, duke shqyrtuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ajo që duhet theksuar si fakt i pakontestueshëm është se kërkesëpadia e parashtruesit për pagesën e tri shpërblimeve jubilarë është aprovuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata konstaton se gjykata e shkallës së parë e ka gjetur bazën e një vendimi të tillë në dispozitat e nenit 52 të Marrëveshjes Kolektive, ndërkohë që konsideron se parashtruesi i kërkesës me vetë faktin se ka punuar gjithsej 38 vjet, më saktësisht deri në vitin 2018, kur ka dalë në pension, i ka plotësuar kushtet e parashikuara në nenin 52 të Marrëveshjes Kolektive.
62. Mirëpo, në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit ka shprehur mendimin e kundërt, dhe rrjedhimisht konkluzionin e kundërt me përfundimin e Gjykatës Themelore, duke konstatuar se e drejta e parashtruesit të kërkesës është njohur nga gjykata e shkallës së parë me aplikim të gabuar të nenit 52 të Marrëveshjes Kolektive.
63. Më konkretisht, gjëja e parë që bëri Gjykata e Apelit në procedurën e shqyrtimit të kërkesës së parashtruesit ishte përcaktimi i periudhës kohore të vlefshmërisë së kontratës kolektive, me ç'rast konstatoi, "*Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka filluar të zbatohet nga 01.01.2015, me kohëzgjatje prej tre vjetësh, përkatësisht deri më 31.12.2017, kur ka skaduar afati për zbatimin e së njëjtës*". Gjykata vlerëson se ky qëndrim i Gjykatës së Apelit është i rëndësishëm dhe kjo për arsye se në bazë të përmbajtjes së kontratës kolektive mund të vërehet si vijon, përkatësisht kur është nënshkruar kontrata kolektive ka pasur një periudhë kohore në të cilën palët mund të ushtrojnë të drejtat e tyre. Ajo periudhë kohore e vlefshmërisë së kontratës kolektive kishte datën e fillimit të zbatimit të saj, si dhe datën kur ajo

pushon së zbatuari. Në atë periudhë të zbatimit të saj, palët mund kanë mundur ushtrojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në nenin 52 të Marrëveshjes Kolektive.

64. Pikërisht, Gjykata e Apelit i referohet kohës kur parashtruesi i kërkesës ka arritur 30 vjet përvojë pune, që në bazë të gjendjes faktike ka qenë në vitin 2009, afati kohor i zbatimit të Kontratës Kolektive, që është periudha prej 1 janarit 2015 deri më 31 dhjetor 2017, si dhe data kur ka parashtruar kërkesën për pagesën e shpërblimeve jubilarë, që është 31 maj 2019, kanë ndikuar që Gjykata e Apelit të konkludojë *“se kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesëpadisë”*, që është në pajtim me nenin 87 të Ligjit të Punës (citur më lart), ku parashihet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.
65. Rrjedhimisht, rezulton se parashtruesi i kërkesës ka mundur të përmbushë kërkesën e tij për pagesën e shpërblimeve jubilarë mbi këtë bazë në periudhën nga 1 janari 2015 dhe kjo e drejtë i takonte atij, në pajtim me nenin 87 të Ligjit të Punës. për 3 vjet, pra deri më 31 dhjetor 2017 kur marrëveshja kolektive ka pushuar së zbatuari.
66. Për më tepër, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit e shqyrtoi kërkesën e parashtruesit nga aspekti i zbatimit të nenit 357 par. 1 i LMD, i cili përcakton se *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”*, në të njëjtën kohë duke vënë në dukje se, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, nga 1 janari 2015, parashtruesit i është dhënë e drejta që të paraqesë kërkesën e tij brenda 3 viteve, dhe se sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, ai nuk e bëri këtë.
67. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit përcaktonte qartë bazat ligjore dhe nenet e ligjeve përkatëse mbi të cilat ai mund të ushtronte të drejtën e tij, si dhe tregoi dhe arsyetoi qartë arsyet pse kërkesa e tij ishte e pabazuar. Prandaj, Gjykata vlerëson se konkluzioni i Gjykatës së Apelit lidhur me konstatimin e gjendjes faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale nuk është arbitrar, siç thekson parashtruesi në kërkesë.
68. Përveç kësaj, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme, me qëllim të shqyrtimit të fakteve dhe zbatimit të së drejtës materiale nga neni 52 i Kontratës Kolektive, shkoi një hap më larg se Gjykata e Apelit, duke dhënë shpjegime që justifikojnë qartë konkluzionin e Gjykatës së Apelit në lidhje me të drejtat e parashtruesit të kërkesës.
69. Në mbështetje të kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në aktgjykim ka prekur gjithashtu çështjen e bazës ligjore të kohëzgjatjes së marrëveshjes kolektive mbi të cilën është lidhur, si dhe efektin e saj kohor në lidhje me kërkesat. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme konstatoi:
 - i) *“se marrëveshja kolektive mbi bazën e së cilës parashtruesi i kërkesës dëshiron të ushtrojë të drejtat e tij është e kufizuar në 3 vjet të vlefshmërisë”*
70. Gjykata konsideron se një konkluzion i tillë i Gjykatës Supreme është plotësisht i justifikuar për arsye se neni 90, paragrafi 4 i Ligjit të Punës përcakton se llojet e tilla të Kontratës Kolektive mund të lidhen për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. Për rrjedhojë, të drejtat e parashikuara në të kanë edhe një afat të kufizuar për realizimin e tyre.

ii) *“Marrëveshja Kolektive, nuk ka efekt retroaktiv”*

71. Kjo, sipas mendimit të Gjykatës, ndikon drejtpërdrejt në pamundësinë e realizimit të të drejtave të të gjithë atyre, nga marrëveshja kolektive, duke përfshirë edhe vetë parashtruesin e kërkesës, që kanë arritur numrin e parashikuar të viteve të përvojës së punës nga neni 52 i Marrëveshjes Kolektive para kohës së zbatimit të saj.
72. Përveç kësaj, Gjykata vëren edhe një argument tjetër të rëndësishëm në arsyetimin e Gjykatës Supreme, përmes të cilit sqaroi plotësisht edhe çështjen, *“nëse personat që kanë fituar të drejtën e pensionit të pleqërisë, por nuk janë kualifikuar për shpërblimin jubilar, kanë të drejta nga marrëveshja kolektive”*. Në mbështetje të kësaj, Gjykata Supreme kishte konkluduar *“Me marrëveshjen kolektive nuk është paraparë e drejta e punëtorit për pagesën e shpërblimit jubilar dhe e pagave përcjellëse për shkuarjen në pension të pleqërisë.”*
73. Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, Gjykata konstaton se edhe në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme, nuk kishte zbatim të gabuar të së drejtës materiale në lidhje me të drejtat e parashtruesit në procedurën e vendimmarrjes lidhur me kërkesën e tij për pagesën e shpërblimeve jubilarë nga neni 52 i Marrëveshjes Kolektive.
74. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në procedurën konkrete gjyqësore në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, nuk ishte shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për një gjykim të drejtë, e parashikuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht, i konsideron këto pretendime të pabazuara.

Pretendimi për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së

75. Gjykata konstaton më tej se parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, duke theksuar se *“Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë vendosur ndryshe në raste të ngjashme, duke e vënë atë në pozitë të pabarabartë para ligjit”*.
76. Në thelb, nga pretendimet rezulton se parashtruesi i kërkesës konsideron se i është shkelur e drejta për ndalimin e diskriminimit nga neni 24 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se diskriminimi ekziston nëse rezulton në trajtim të ndryshëm të individëve në situata të ngjashme dhe nëse ai trajtim nuk ka justifikim objektiv ose të arsyeshëm. Në mënyrë që të jetë i justifikuar, trajtimi duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të ketë një lidhje të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që duhet të arrihet (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, [Marekx kundër Belgjikës](#), kërkesa [nr. 6833/74](#), e 13 qershorit 1976, paragrafi 33). Prandaj, është e nevojshme të përcaktohet në çdo rast konkret nëse parashtruesi i kërkesës është trajtuar ndryshe nga të tjerët në situata të njëjta ose të ngjashme..
77. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i lidh pretendimet për diskriminim me qëndrime të ndryshme të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme në procedurën e vendimmarrjes në situata të ngjashme, me ç'rast dorëzoi në Gjykatë një aktgjykim të Gjykatës Supreme, përmes të cilit ishte vendosur lidhur me ushtrimin e të drejtave nga neni 52 i marrëveshjes kolektive, si provë që justifikon pretendimin e tij.
78. Megjithatë, duke marrë parasysh konkluzionet e Gjykatës në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë nga pikat e mëparshme të këtij vendimi, sipas të cilave arsyetimet e vendimeve të kontestuara janë të qarta dhe logjike dhe se në to nuk ka elemente që

tregojnë se vlerësimi i fakteve në rastin konkret është keqpërdorur në dëm të parashtruesit të kërkesës, dhe as që zbatimi i së drejtës materiale dhe procedurale ka qenë arbitrar, konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë janë të pabazuara.

79. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata konsideron se në këtë pjesë të vendimit është e rëndësishme të theksohet se më 27 shkurt 2023, Gjykata Supreme ka nxjerrë një mendim juridik në lidhje me *“kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar nga marrëveshja kolektive”*.
80. Gjykata, pas shqyrtimit të mendimit juridik të Gjykatës Supreme, konsideron se ai jep një pasqyrë të plotë dhe zgjidh shumë çështje që kanë qenë në juridiksionin e gjykatave të rregullta lidhur me ushtrimin e të drejtave nga marrëveshja kolektive. Gjykata gjithashtu konstaton se Gjykata Supreme në mendimin e saj juridik ka deklaruar *“në praktikën e saj gjyqësore, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta ka konstatuar praktikë jo unike lidhur me çështjen e kërkesave për shpërblimin jubilar. Praktika jo unike e gjykatave të instancave më të ulëta kryesisht ka të bëjë me periudhën kohore që duhet të aplikohen marrëveshja e përgjithshme kolektive dhe kontratat sektoriale, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar”*.
81. Gjykata konsideron se neni 27 i Ligjit për Gjykatat parasheh kompetencën e Gjykatës Supreme të Kosovës për nxjerrjen e një mendimi juridik në rastet kur vërehet një praktikë jo unike e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta, apo kontestimit të zbatimit dhe interpretimit të dispozitave ligjore, me qëllim të marrjes së qëndrimeve parimore, vendimeve dhe udhëzimeve juridike që promovojnë zbatimin unik të ligjeve në territorin e Kosovës.
82. Gjykata duhet të theksoj se ky mendim juridik i Gjykatës Supreme nuk ndikon drejtpërdrejt në rezultatin e kësaj kërkesë të parashtruesit për arsyet që Gjykata i ka theksuar tashmë në pjesët e aktvendimit kur ka vlerësuar bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme.

Pretendimi për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së

83. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 13 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson se është shkelur parimi i barazisë së armëve, për shkak se është vendosur në pozitë të pafavorshme në raport me të paditurën, sepse e drejta materiale nuk është zbatuar në mënyrën e duhur gjatë vendosjes lidhur me mjetin efektiv juridik.
84. Mbi bazën e këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton se, për nga përmbajtja, ky pretendim i referohet në thelb gjykimit të drejtë dhe diskriminimit, të cilin Gjykata e ka analizuar tashmë në pjesët e mëparshme të këtij aktvendimi, ndërsa për sa i përket pjesës së pretendimit për efektivitetin e mjetit juridik, për Gjykatën është më se e dukshme se parashtruesi i kërkesës ka pasur në dispozicion mjete juridike gjatë gjithë procedurës gjyqësore, të cilat i ka përdorur për të ushtruar të drejtat e tij.
85. Prandaj, Gjykata e gjen gjithashtu këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të neneve 54 dhe 102 të Kushtetutës

86. Në kërkesë, Gjykata gjithashtu vëren se parashtuesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 54 dhe 102 të Kushtetutës, por ato nuk i arsyeton në asnjë mënyrë në vetë kërkesë, dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk do t'i trajtojë ato në vijim.

Përfundim

87. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 31, 32, 54 dhe 102 të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së janë pretendime që kualifikohen si (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”. Prandaj, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në tërësi, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 janar 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani